


# FONDI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETIT



PËR NJË PERIUDHË SHSTATË VJEÇARE  
2019 - 2025



### “KOSOVA E RE”, MË SHUMË SE ENERGJI

Një nga përfitimet e menjëhershme nga termocentrali “Kosova e Re” është themelimi i Fondit për Zhvillimin e Komunitetit (FZhK) në vlerë prej 10 milionë euro, të ndara nga investitori ContourGlobal.

Ky fond do të disbursohet pas fillimit të ndërtimit për një periudhë 7 vjeçare. Gjatë gjashtë viteve të para me nga 1.5 milionë euro në vit, dhe 1 milion euro në vitin e shtatë.

FZhK do të përkrahë lokalitetet që ndikohen nga projekti. Qëllimi është të ndihmojë komunitetet t’i përmirësojnë mjediset e tyre sociale dhe ekonomike si dhe ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve për përfshirje në proceset vendimmarrëse me qëllim të përmirësimit të kushteve të tyre të jetesës.

Qëllimet që fondi synon t’i arrijë janë: të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit përtej një gjenerate; zhvillim të planifikuar mirë me dobi afatgjata; si dhe të përkrah planet zhvillimore lokale në fushën e edukimit, ambientit, ndërmarrësisë dhe shëndetit.

Bordi i FZhK-së përbëhet nga 4 anëtarë. Qeveria e Kosovës dhe investitori ContourGlobal përfaqësohen me nga dy anëtarë, të cilët vetëm në mënyrë unanime do të përzgjedhin projekt propozimet që do të financohen nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit.

